



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
Komisioni i Konkurrencës

V E N D I M

Nr. 144, Datë 23.03.2010

Rekomandim për Entin Rregullator të Energjisë për liçencimin e dy shoqërive "Cable Sistem" Sh.p.k dhe 400 KV" Sh.p.k.

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e :

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Rezana Konomi Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 23. 03.2010, shqyrtoi çështjen me :

Objekt: Dhënie rekomandimi për liçensimin e dy shoqërive "Cable Sistem" Sh.p.k dhe 400 KV" Sh.p.k, nga Enti Rregullator i Energjisë Elektrike.

Baza ligjore: Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", neni 24, shkronja d dhe f, dhe neni 70.

V Ë R E N S E:

Enti Rregullator i Energjisë Elektrike (ERE), me shkresën Nr. 119 Prot. date 8 Mars 2010, i ka kërkuar Autoritetit të Konkurrencës mendimin lidhur me aplikimin për pajisjen me licence të dy shoqërive "Cable Sistem" Sh.p.k dhe 400 KV" Sh.p.k.

Shoqëria tregtare "Energji" Sh.p.k, ka krijuar në bazë të ligjit Nr. 9901, datë 18.04.2008 "Për tregtarin dhe shoqëritë tregtare" dy shoqëri të tjera përkatësisht:

- "Cable Sistem" Sh.p.k, tek e cila zotëron 90% të kuotave të kapitalit themeltar;
- "400 KV" Sh.p.k, tek e cila zotëron 99% te kuotave te kapitalit themeltar.

Të dyja këto shoqëri ("Cable Sistem" Sh.p.k dhe " 400KV" Sh.p.k) kanë aplikuar pranë ERE-s për tu pajisur me licencë për tregtimin e energjisë elektrike sipas ligjit Nr. 9072, date 23.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" dhe konform "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit te licencave" .

Aktualisht te dyja shoqëritë kanë marre nga ERE vendimin për fillimin e procedurave te shqyrtimit të aplikimit për liçencë dhe është në vazhdim procedura për liçensimin e tyre. ERE, pas publikimit ne median e shkruar, është ne pritje të ankesave nga palët e treta ne lidhje me këto aplikime.

Në tregun e energjisë elektrike aktualisht operojnë mbi 8 shoqëri për tregtimin e energjisë elektrike, të cilat kanë aktivitetet relativisht të reduktuar për shkak se janë operatorë të licensuar vitet e fundit në treg dhe për shkak se importet dhe eksportet e energjisë elektrike kryhen kryesisht nëpërmjet shoqërive të huaja.

Pajisja e dy shoqërive si më sipër me licensën e tregtimit do të bëjë që në treg të operojnë mbi 10 shoqëri. Ky fakt nuk e pengon apo çënon konkurrencën pasi shoqëria "Energy" apo dy shoqëritë që do të licensohen nuk kanë fuqi tregu me efekte për konkurrencën.

Gjithësesi, sjellja e dy shoqërive të reja në tregun e energjisë elektrike do të jetë objekt monitorimi i Autoritetit të Konkurrencës për shkak të zotërimit nga e njëjta shoqëri.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe f si dhe nenit 70, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës":

VENDOSI:

1. T'i rekomandojë Entit Rregullator të Energjisë Elektrike të pajisë me liçensë për tregtimin e energjisë elektrike shoqëritë "Cable Sistem" Sh.p.k dhe "400KV" Sh.p.k .
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e Entit Rregullator të Energjisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Servete GRUDA

(_____)

Anëtar

Koço BROKA

(_____)

Anëtar

Rezana KONOMI

(_____)

Anëtar

Lindita MILO (LATI)

K R Y E T A R